

**Heb's-AL SH.P.K.**  
**TIRANË - SHQIPËRI**

**AKT THEMELIMI**

**Më 24 janar 2024**

Sot, më 24.01.2024, ortakët e Shoqërisë, si në vijim:

- **Z. Arbër Brahimi**, shtetas kosovar, i lindur më 05.05.1995, në Mitrovicë, Kosovë, mbajtës i pasaportës me nr. personal 1172842905;
- **Z. Basri Brahimi**, shtetas kosovar, i lindur më 06.06.1969, në Mitrovicë, Kosovë, mbajtës i pasaportës me nr. personal 1004722058;
- **Z. Kastriot Brahimi**, shtetas kosovar, i lindur më 23.10.1995, në Mitrovicë, Kosovë, mbajtës i pasaportës me nr. personal 1172842867;
- **Z. Taulant Brahimi**, shtetas kosovar, i lindur më 30.09.2002, në Mitrovicë, Kosovë, mbajtës i pasaportës me nr. personal 1172842859;
- **Z. Lirim Brahimi**, shtetas kosovar, i lindur më 24.03.1999, në Mitrovicë, Kosovë, mbajtës i pasaportës me nr. personal 1172842875;
- **Z. Ardian Brahimi**, shtetas kosovar, i lindur më 07.03.1997, në Mitrovicë, Kosovë, mbajtës i pasaportës me nr. personal 1172842913;
- **Z. Arbresha Brahimi**, shtetase kosovare, e lindur më 27.01.1992, në Mitrovicë, Kosovë, mbajtëse e pasaportës me nr. personal 1172842883;
- **Z. Hilmi Brahimi**, shtetas kosovar, i lindur më 24.10.1966, në Mitrovicë, Kosovë, mbajtës i pasaportës me nr. personal 1020668233;
- **Z. Albulena Brahimi**, shtetase kosovare, e lindur më 10.09.1993, në Mitrovicë, Kosovë, mbajtëse e pasaportës me nr. personal 1172842891,

këtu e në vijim referuar bashkërisht si “Ortakët”, miratuan këtë Akt Themelimi, si më poshtë:

### Neni 1 Themelimi dhe forma ligjore

Ortakët deklarojnë krijimin dhe themelimin e një shoqërie shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, përkatësisht Heb's-AL SH.P.K. (këtu e në vijim referuar si “Shoqëria”), në përputhje me dispozitat e ligjit shqiptar nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (këtu e në vijim referuar si “Ligji për Shoqëritë Tregtare”). Shoqëria do të themelohet për një kohëzgjatje të pacaktuar.

### Neni 2 Selia e regjistruar e Shoqërisë

Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën: Rruga Kadri Prishtina, Nr. i pasurisë 60/105+3-N10, ZK 2679, 1010 Tiranë, Shqipëri.

HB K.B A.B L.B A.B BB  
TB A.B A.B

**Neni 3**  
**Objekti i aktivitetit të Shoqërisë**

3.1. Objekti i Shoqërisë do të përfshijë aktivitetet e mëposhtme:

- a) Restorantet dhe aktivitetet shërbyese lëvizëse të ushqimit, hotelet dhe akomodime të ngjashme;
- b) Përpunimi i mishit të pulës dhe gjedhit;
- c) Furnizimi me ushqim, me porosi për raste të ndryshme, katering;
- d) Prodhimi i akullores;
- e) Prodhimi i bukës, simiteve dhe embëlsirave të freskëta;
- f) Tregtia me shumicë e kafshëve të gjalla;
- g) Tregtia me shumicë e produkteve të qumështit, vezëve, vajrave, dhe yndyrnave të gatimit;
- h) Tregtia me shumicë e artikujve të tjerë ushqimore, përfshirë mishin e pulës, mishin e viçit, peshkun, krustacet dhe molusqet (frutat e detit);
- i) Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe cigarja;
- j) Shërbimet e shpërndarjes së ushqimit;
- k) Import / Eksport.

3.2. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, për përmbushjen e objektit të lartpërmendur, Shoqëria mund:

- a) të aplikojë dhe të pajiset me një ose të gjitha licencat dhe autorizimet e nevojshme, si dhe të kryejë aktivitete tregtare, financiare, qira apo hipotekore të cilat mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për përmbushjen e objektit të Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara me sipër;
- b) të blejë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, interesa në shoqëri të tjera që kanë objekt (objekti i aktiviteti) të ngjashëm me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj;
- c) të kryejë aktivitete publikimi, marketingu e reklamimi;
- d) të kryejë aktivitete për shitjen me pakicë apo shumicë të mallrave, pajisjeve siç mund të konsiderohet e përshtatshme;
- e) të kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë.

3.3. Shoqëria do të kryejë çdo aktivitet që përfshihet në objektin e saj të aktivitetit dhe/ose që lidhet me objektin e saj.

3.4. Shoqëria do të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse dhe standardet më të mira etike, në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 4**  
**Statuti**

Ortakët deklarojnë miratimin dhe zbatimin e Statutit të Shoqërisë. Aktiviteti dhe veprimtaria e Shoqërisë do të kryhen në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe rregullat e detyrueshme të legjislacionit shqiptar.

H.B      K.B  
T.B      A.B      L.B<sup>3</sup>      A.B      BB  
A.B      A.B

## Neni 5 Kapitali

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 9,342,900.00 (nëntë milionë e treqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind) Lekë, i ndarë në 9 (nëntë) kuota me vlerë nominale të barabartë me 1,038,100.00 (një milion e tridhjetë e tetë mijë e njëqind) Lekë, sipas së cilës secili ortak zotëron 11.11% në kapitalin e Shoqërisë, i zotëruar plotësisht nga Ortakët e Shoqërisë.

## Neni 6 Administratori

6.1. Administratori i Shoqërisë është:

- **Z. Kastriot Brahimi**, shtetas kosovar, i lindur më 23.10.1995, në Mitrovicë, Kosovë, mbajtës i pasaportës me nr. personal 1172842867, i cili ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë para të tretëve me nënshkrimin e tij personal ("Administratori").

6.2. Administratori emërohet për një afat në detyrë prej 2 (dy) vitesh me të drejtë rizgjedhjeje.

6.3. Të gjitha detyrimet, të drejtat dhe kufizimet e Administratorit janë të detajuara në Statutin e Shoqërisë.


## Neni 7 Autorizimet

Ortakët autorizojnë **Znj. Ana Goro**, shtetase shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal I55303082E dhe/ose **Znj. Juna Rexha**, shtetase shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. J86225060S dhe/ose **Znj. Elona Mena**, shtetase shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal J75211034C, bashkërisht ose individualisht, të hartojnë, nënshkruajnë, ekzekutojnë dhe dorëzojnë në emër të Shoqërisë çdo dokument të nevojshëm për të plotësuar dhe bërë efektiv regjistrimin e Heb's-AL SH.P.K., pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, dhe çdo autoriteti kompetent tjetër siç kërkohet me ligj.

Akti i Themelimit është hartuar në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare", i ndryshuar.

### ORTAKËT E Heb's-AL SH.P.K.


ARBËR BRAHIMI

ARBËR BRAHIMI  


BASRI BRAHIMI

BASRI BRAHIMI  


KASTRIOT BRAHIMI

KASTRIOT BRAHIMI  


TAULANT BRAHIMI

Taulant Brahimi

T Brahimi

LIRIM BRAHIMI

Lirim Brahimi

L Brahimi

ARDIAN BRAHIMI

Ardian Brahimi

A Brahimi

ARBRESHA BRAHIMI

Arbresha Brahimi

A Brahimi

HILMI BRAHIMI

Hilmi Brahimi

H Brahimi

ALBULENA BRAHIMI

Albulena Brahimi

A Brahimi

HEB'S-AL SHPK  
RRUGA  
KADRI PRISHTINA  
TIRANE, SHQIPERI